

KAPITULLI III

MARRDHENIET E PUNËS
DHE MBROJTJA NË GJYKATË

2015-2018



PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE **MARRDHËNIET E PUNËS NË GJYKATË**

Prej vitit 2014, INFOCIP implementon Programin e Vlerësimeve Tematike të pavaruara në sistemin e Gjykatave Administrative. Një fokus i posaçëm brenda këtij Programi është vlerësimi sistematik i çështjeve gjyqësore me objekt “*marrdhëniet e punës*”. Gjykatat janë vija e fundit garantuese e të drejtave të punës. Për çështjet që nuk përfaqësohen nga sektori sindikal, gjykatat përfaqësojnë njëkohësisht edhe vijën e parë të mbrojtës së këtyre të drejtave.

Republika e Shqipërisë i ka dedikuar vend të posaçëm në Kushtetutën e saj të drejtave të punës (Kreu IV). Në zbatim të garancive kushtetuese, shteti shqiptar ka ratifikuar dhjetëra konventa që promovojnë dhe garantojnë të drejtat dhe dinjitetin në punë. Kuvendi, në zbatim të Kushtetutës dhe konventave ndërkombëtare të ratifikuara ka hartuar dhjetëra kode dhe ligje të cilat e bëjnë Shqipërinë ndër vendet me legjislacion të pasur për punën dhe marrdhëniet që ajo krijon mes shtetit dhe individit apo mes kompanive private dhe të punësuarve prej tyre.

Në vitin 2012, Shqipëria hartoi dhe miratoi ligjin nr. 49/2012 “*Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative*”. Sipas këtij ligji, institucioni publike që është në konflikt gjyqësor me individin, përfshirë marrdhëniet e punës, ka barrën e provës. Për fat të keq, ndryshimet ligjore të vitit 2016, e cënuan këtë parim të rëndësishëm, duke i caktuar gjykatave administrative fushë veprimi që limitohet vetëm për konflikte punësimi ku palë është shteti dhe punënjësit e tij që gëzojnë statusin e nëpunësit civil.



Tematika e marrdhënieve të punës në sistemin e gjykatave administrative u trajtua për herë të parë në Konferencën Kombëtare të zhvilluar në Dhjetor 2017 nga INFOCIP, në të cilën mori pjesë Presidenti i Republikës, SH.T.Z. Ilir Meta, në cilësinë e kryetarit të KLD, kryetari Gjykatës së Lartë, Z. Xhezair Zaganjori, kryetari i Gjykatës Administrative të Apelit, Z. Kastriot Selita si dhe gjithë kryetarët e gjykatave të tjera administrative¹. Ndër problematikat e evidentuara në këtë Konferencë, ishte dhe volumi i lartë i çështjeve gjyqësore me objekt “*Pushimin e padrejtë nga puna*” si dhe numri i lartë i rekurseve me objekt “*pensionet e ushtarakëve*” dhe sigurimet shoqërore të punonjësve në përgjithësi.

Në vijim të rekomandimeve të kësaj Konference të rëndësishme, INFOCIP ndërmoi një vlerësim të posaçëm, për të evidentuar shpeshtësinë e këtij lloj konflikti gjyqësor, mënyrën e zgjidhjes së tij gjyqësisht, si dhe totalin e dëmshpërblimit që organet publike detyrohen nga gjykata të paguajnë në rast humbjeje të gjyqit. Të dhënat e këtij vlerësimi përfshijnë vitet 2017 dhe 2018 për ankimet e gjykuara në Apelin Administrativ.

Po ashtu Vlerësimi Special tematik për marrdhëniet e punës në gjykatë ka analizuar të gjitha rekursat për vitet 2015-2016 dhe 2017 në Gjykatën e Lartë dhe mënyrën e zgjidhjes së tyre. Gjetjet

janë organizuar në një sistem të posaçëm online, www.gjykataehapur.al që mundëson verifikimin e të dhënave si dhe lejon përpunime të imtësishme nga palët e interesuara.

Vlerësimi tematik për marrdhëniet e punës në Gjykatën Administrative të Apelit për vitin 2017 është mbështetur nga Qeveria Suedeze, përmes SIDA dhe Olof Palme Center. Sa i takon analizës dhe vlerësimin të këtyre lloj padive për vitin 2018, INFOCIP ka mbështetur me burimet e veta të gjithë *research-in*.

Vlerësimi Tematik për Gjykatën e Lartë për vitet 2015, 2016 dhe 2017 është mbështetur nga National Endowment for Democracy, NED, me seli në Washington D.C. Nga ky studim, INFOCIP ka “filtruar” më pas të gjitha rekursat me objekt marrdhëniet e punës, për të përlllogaritur raportin **çështje të fituara vs. çështje të humbura**.

¹ Punimet e Konferencës mund të hapen në këtë link: <http://www.infocip.org/al/?cat=213>

Për herë të parë, INFOÇIP ka organizuar dhe analizuar online të dhënat e këtij Vlerësimi, përmes Platformës Kombëtare www.gjykataehapur.al. Ajo që përbën risi absolute janë skedat e përpunuara për çdo çështje gjyqësore me objekt “*marrdhëniet e punës*”. Këto skeda pasqyrojnë historikun e gjykimit të çështjes gjyqësore në të treja shkallët. Sigurisht, interesim më të madh përfaqësojnë skedat të cilat kanë të bëjnë me gjykimet dhe vendimet deri në shkallën e dytë të gjykimit administrativ, pasi nga ky moment e tutje, vendimi gjyqësor bëhet i ekzekutueshëm.

Ndërkohë, skedat e përpunuara për rekursin në Gjykatën e Lartë, ofrojnë një panoramë të plotë të dinamikës së gjykimit në të treja shkallët sa i takon çështjeve gjyqësore me objekt “*pushimet nga puna*”. Duke qënë se analiza fillon nga viti 2015 dhe përfundon në vitin 2017, INFOÇIP konsideron se kjo fashë kohore është përfaqësuese për të krijuar një opinion të përgjithshëm mbi mënyrën e zgjidhjes së këtyre lloj rekurseve nga ana e Gjykatës së Lartë. Studimi i posaçëm i këtyre skedave do të ndihmojë që të kuptohen më mirë shanset për të fituar një rekurs me këtë objekt në Gjykatën e Lartë.

Vlerësimi Tematik Special për marrdhëniet e punës në gjykatë dhe evidencat që ai ka analizuar mund të shfletohet i gjithi online në Platformën Kombëtare www.gjykataehapur.al dhe konkretisht në: www.gjykataehapur.al/te-drejtat-e-punes-dhe-mbrojtja-ne-gjykate

Tabelat respektive në të cilat afishohen këto evidence janë të përpunueshme në formatin open-data dhe janë të pajisuar me funksione filtrimi dhe rankimi, të cilat lejojnë përpunim të larmishëm të të dhënave. Ato vijnë për herë të parë në përdorim të publikut duke caktuar një standard të ri në vlerësimet tematike në gjykata. INFOÇIP synon që ta pasurojë më tej këtë sistem të automatizuar vlerësimi tematik për sistemin e gjykatave të RSH, për ti ardhur më mirë në ndihmë edhe institucioneve të tjera të interesuara në përdorimin e këtyre lloj të dhënave.

TE DREJTAT E PUNES & MBROJTJA NE GJYKATE

LEJO ME SHUME

GJYKATAT E ZAKONSHME



GJYKATA ADMINISTRATIVE



GJYKATA E LARTE



TE DREJTAT E PUNES DHE MBROJTJA E TYRE NE GJYKATEN ADMINISTRATIVE

INFOCIP ANALIZON PER HERE TE PARE EVIDENCOAT GJYQESORE

Prej vitit 2014, INFOCIP implemeton Programin e Vleresimeve Tematike te pavaruara ne sistemin e Gjykatave Administrative. Nje fokus i posacem brenda ketij programi eshte vleresimi sistematik i cheshtjeve gjyqesore me objekt "marrdheniet e punes".

Gjykatat administrative jane vija e fundit garantuese e te drejteve te punes. Republika e Shqiperise e ka dedikuar nje vend te posacem ne Kushtetuten e saj te drejteve te punes. Po ashtu, shteti shqypar ka ratifikuar dhjetera konventa qe promovojne dhe garantojne te drejtat dhe dinjitetin ne pune. Kuvendi, ne zbatim te Kushtetutes dhe konventa nderkombetatare te ratifikuara ka hartuar dhjetera kode dhe ligje te cilat e bejne shqiperine nje ndr vendet me legjislacion te pasur per punen dhe marrdheniet qe ajo krijon mes shtetit dhe individit apo kompanive private dhe te punesuarve prej tyre.

Nje vitin 2012, Shqiperia hartoi dhe miratoi ligjin nr. 49/2012 "Per Organizimin dhe Funkcionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e mosmarrveshjeve administrative". Sipas frymes se ketij ligji te rendesishme, nese institucionet publike beheshin pajale gjyqesore ne nje konflikti mbi marrdheniet e punes, barra e proves i ngarkohet atyre. Per fat te keq, ndryshimet e vitit 2016, e cenuan kete parim te rendesishem duke e caktuar gjykatave administrative fusha te re veprimi qe limitohet vetem per zgjidhjen e konfliktit te punesimit mes shtetit dhe punonjeseve te tij, kur keta te fundit gjejne statusin e nepunesit civil.

Tematika e marrdhenieve te punes ne sistemin e gjykatave administrative u trajtua per here te pare ne Konferencen vjetore te zhvilluar ne Dhjetor 2017, ne te cilen mori pjesë Presidenti i Republikës, SH.T.Z. Ilir Meta, në cilësinë e kryetarit të KLD, kryetari i SJJL, Z. Xhezair Zaganjori, kryetari i GJAA të Apelit, Z. Kastriot Selita si dhe gjithë kryetarët e gjykatave të tjera administrative.

Ndër problematikat e evidentuara në këtë Konferencë, ishin jo vetëm pushimet e padrejta nga puna, por edhe volumi i lartë i tyre, idomos në kohët e rotacioneve të pushtetit. Në vijim të rekomandimeve të kësaj Konferencë të rëndësishme, INFOCIP ndërmori një vlerësim të posaçëm gjatë vitit 2018, në të cilën analizoi të gjithë cheshtjet e vendimura në vitin 2017 dhe 2018 për të evidentuar dhe analizuar cheshtjet gjyqesore me objekt "marrdheniet e punes" si dhe vonesat e shqyrtimit të tyre nga gjykatat administrative.

Në këtë faqe, ju mund të njoheni me evidencat e këtij monitorimi, i cili zhvillohet për herë të parë mbi këtë tematikë special në shqipëri, duke patur si pikënisje vendimet e gjykatave administrative të RSH.

Rekurset, marrdheniet e punes, GJYKATA E LARTE

GJYKATA E APELIT ADMINISTRATIV Marrdheniet e punes



AKTIVITETE TE MEPARSHME



National Endowment for Democracy Supporting freedom around the world



GJYKATA E LARTË REKURSET PËR MARDHENIET E PUNES


VLERËSIMI PËR VITIN 2017, KOLEGJI ADMINISTRATIV

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë dha gjithsej 895 vendime në vitin 2017. Prej tyre, 91 ishin rekurse me objekt marrdhëniet e punës. Këto rekurse të vendimura në 2017-ën përfaqësojnë rreth **10%** të totalit të vendimimeve nga ky Kolegj në 2017-ën.


Rezulton se 462 rekurse të vendimura në vitin 2017 nga Kolegji Administrativ i GJL, të cilat përfaqësojnë **51%** të totalit, janë me objekt pensionet dhe sigurimet shoqërore.

Në total, çështjet me karakter social-ekonomik, nëse përfshihen edhe marrdhëniet e punës si kategori më vete, zunë **61%** të totalit të çështjeve të vendimura nga Kolegji Administrativ i GJL në vitin 2017.

Nga një analizë e ndërmarrë ndaj vendimeve që u dhanë në 2017 për rekursat me objekt “marrdhënie pune”, rezultoi se Gjykata e Lartë la në fuqi një dëmshpërblim të përgjithshëm prej 801 pagash mujore. Ato grupohen në 50 çështje/rekurse të vendimura nga 91 të shqyrtuara në 2017-ën.



Mesatarja e shqyrtimit të rekurseve me objekt marrdhëniet e punës është 925 ditë krahasuar me 892 që është mesatarja totale e Gjykatës së Lartë për vitin 2017.




INFOCIP ka organizuar të gjithë çështjet me objekt “Marrdhëniet e Punës” në një databazë të posaçme e cila është e shfletueshme në Platformën Kombëtare www.gjykataehapur.al

Show 100 entries

Nr.Vendimi	Regjistri i Rekursit	Data e vendimit te Gj.L	Dëmshpërblimi financiar	Skeda e Gjykitimit
39	25.05.2012	07.02.2017	12 paga mujore	SHKARKO
40	30.05.2012	07.02.2017	dëmshperblim deri ne ekzekutimin e vendimit	SHKARKO
54	03.11.2014	07.02.2017	2 paga mujore	SHKARKO
55	23.02.2015	07.02.2017	19 paga mujore	SHKARKO
56	18.06.2015	07.02.2017	19.5 paga mujore	SHKARKO
81	20.06.2014	14.02.2017	12 paga mujore	SHKARKO
122	09.03.2015	21.02.2017	dëmshperblim deri ne ekzekutimin e vendimit	SHKARKO
123	17.04.2015	21.02.2017	dëmshperblim deri ne rikthim ne pune	SHKARKO


VLERËSIMI PËR VITIN 2016, KOLEGJI ADMINISTRATIV

Kolegji Administrativ i GJL dha gjithsej 602 vendime në vitin 2016, nga të cilat vetëm 77 ishin rekurse me objekt “marrdhëniet e punës”.




Kolegji Administrativ i GJL la në fuqi vendimet paraardhëse (plotësisht ose pjesërisht) për 31 rekurse. Të grupuara dhe të analizuara, këto 31 rekurse të vendimuara në vitin 2016 përkthehen në një total prej 365 pagash mujore të cilat do të duhet të paguhen si dëmshpërblim për pushime të padrejta nga puna.

Mesatarja e shqyrtimit të rekurseve me objekt marrdhëniet e punës është 660 ditë krahasuar me 820 që është mesatarja totale e Gjykatës së Lartë për vitin 2016.




VLERËSIMI PËR VITIN 2015, KOLEGJI ADMINISTRATIV

Kolegji administrativ i GJL dha gjithsej 757 vendime, s nga te cilat 55 jane dhënë për çështje me objekt marrdheniet e punës të cilat përbëjnë 7.3% të totalit



Kolegji Administrativ i GJL la në fuqi vendimet paraardhëse (plotësisht ose pjesërisht) për 29 rekurse. Të grupuara dhe të analizuara, këto 29 rekurse të vendimuara në vitin 2015 përkthehen në një total prej 213 pagash mujore të cilat do të duhet të paguhen si dëmshpërblim për pushime të padrejta nga puna.

Mesatarja e shqyrtimit të rekurseve me objekt marrdheniet e punës është 903 ditë krahasuar me 968 që është mesatarja totale e Gjykatës së Lartë për vitin 2015.






GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT ANKIMET PER MARDHENIET E PUNES

VLERËSIMI SPECIAL TEMATIK, VITI 2018


Në total për vitin 2018, Gjykata Administrative e Apelit dha gjithsej 4743 vendime për çështje themeli. Prej këtij totali, **1400 vendime** janë dhënë për çështje gjyqësore me objekt marrdhëniet e punës. Këto përfaqësojnë 29.5% të totalit të ngarkesës gjyqësore për vitin 2018 në GJAA.



Nga të dhënat e siguruar prej INFOCIP, mund të përpunohej informacion për **1395 çështje të vendimuara në vitin 2018**, me objekt “marrdhëniet e punës”. Me përpunim informacioni në këtë rast kuptohet konsolidimi i dispozitivit të vendimit në të dyja shkallët e gjykimit. Ky lloj përpunimi lejon përllogaritjen e pagave të cilat shteti detyrohet të paguajë përmes thesarit ndaj palëve gjyqësore që kanë fituar gjykimin administrativ. *Rezulton se:*

1. Për 1263 çështje të vendimuara në Gjykatën e Apelit Administrativ në 2018-ën, shkon për ekzekutim një dëmshpërblim total prej **7638 pagash** (në dispozitivin e këtyre 1263 vendimeve gjendet i përshkruar në mënyrë fikse totali i pagave që institucioni publik duhet t'i paguajë paditësit për pushim të padrejtë nga puna).
2. Në vitin 2018 janë dhënë edhe 132 vendime të cilat njohin të drejtën e paditësit për të marrë pagë deri sa ai/ajo të sistemohen në punë, pasi më parë është konstatuar largimi i tyre në kushte paligjshmërie. E përlogaritur nga INFOCIP, rezulton se deri në fund të vitit 2018, masa e këtij lloj dëmshpërblimi të pa-fiksuar në kohë apo në numër të caktuar pagash (psh 3 paga apo 12 paga mujore) kishte arritur në një total prej **2987 pagash** (pagesa deri në rikthime në punë për 132 çështje mund të vijojë rritjen e vlerës së dëmshpërblimit në 2019-ën, por ky jashtë objekt të këtij vlerësimi).

Ndërkohë janë 385 çështje gjyqësore me objekt marrdhëniet e punës për të cilat GJAA ka rrëzuar vendimin e shkallës së parë që i jepte të drejtë pretendimeve të paditësit ose kur vetë shkalla e parë i ka rrëzuar me vendim themeli pretendimet e paditësit; në këtë rast GJAA ka lënë në fuqi vendimin e saj. Kjo përfaqëson rreth 28% të çështjeve të vendimuara në vitin 2018, të cila ka analizuar ky studim (1395)



Totali i pagave, të cilat duhen paguar nga fondet publike, konform urdhërimit të vendimeve të gjykatave administrative, pas shqyrtimit në Apel është i përlogaritur si shumë e dy kategorive bazë të mësipërme, ku (1) + (2) = 10625 paga gjithsej.

Ky vlerësim tematik i posaçëm për marrdhëniet e punës dhe mbrojtjen e tyre në gjykatë nuk thellohet më tej në datajimin e secilës pagë për secilin paditës që ka fituar çështjen në shkalla të dytë. Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT, paga mesatare në sektorin publik deri në fund të vitit 2017 ishte 61600 lekë ose rreth 493 Euro (kurs mesatar 125). Sipas kësaj konjkturë zyrtare, rezulton se pushimet nga puna në administratën publike, fatura e përgjithshme e cila do të duhet të ekzekutohet nga Shteti për çështjet gjyqësore të humbura prej tij në Apelin Administrativ në 2018-ën është rreth 654.5 milion lekë të reja ose rreth 5.2 milion Euro.


Nga analizimi i të dhënave gjyqësore rezultojnë edhe 3 çështje të vendimuara po në vitin 2018, për të cilat është urdhëruar nga gjykata detyrimi i palës së paditur (institucion publik/shtetëror) për t'i paguar paditësve vlerën monetare prej 1.727.982 leke ose rreth 14 mijë Euro në total. Në këto vendime, masa e dëmshpërblimit nuk përlllogaritet në numër pagash, por si vlerë e përgjithshme financiare.

Në total, masa e dëmshpërblimeve që institucionet publike iu detyrohen të pushuarave nga puna, të cilët kanë fituar proceset gjyqësore në shkallë të dytë (GJAA) gjatë vitit 2018 përlllogaritet në rreth 5.3 milion Euro.

Rezulton se në vitin 2018, GJAA ka vendimuar çështje me objekt “marrdhëniet e punës” të regjistruara në vitit 2014, 2015 dhe 2016 dhe vetëm pak prej tyre i takojnë 2013-ës.


Tabela më poshtë ofron një paraqitje të mënyrës se si janë shpërndarë në fasha të ndryshme masa e dëmshpërblimit për paditësit që kanë fituar çështjet e tyre në GJAA. Rezulton se masa e dëmshpërblimit që haset më shpesh në vendimet gjyqësore që lihen në fuqi në shkallë të dytë është është ajo nga 1 deri në 10 paga.

Fasha	Numri i çështjeve	Paga të dhëna
1-10 paga	290	1890 paga
11-20 paga	273	3884 paga
21-30 paga	95	2430 paga
Mbi 31 paga	61	2400 paga



VLERËSIMI SPECIAL TEMATIK, VITI 2017

Në total për vitin 2017, GJAA dha gjithsej 5521 vendime përfundimtare për çështje administrative themeli. Prej këtij totali, 1601 vendime janë dhënë për çështje gjyqësore me objekt marrdhëniet e punës. Këto përfaqësojnë afërsisht 30% të totalit të ngarkesës gjyqësore për vitin 2017 në GJAA.



Nga të dhënat e siguruara prej INFOCIP, mund të përpunohej informacion për **1514 çështje të vendimuara në vitin 2017**, me objekt “marrdhëniet e punës”. Me përpunim informacioni në këtë rast kuptohet konsolidimi i dispozitivit të vendimit në të dyja shkallët e gjykimit. Ky lloj përpunimi lejon përlllogaritjen e pagave të cilat shteti ka detyrim të paguajë përmes thesarit ndaj palëve gjyqësore që kanë fituar gjykimin administrative në Apel. *Rezulton se:*

1. Për 1377 çështje të vendimuara në Gjykatën e Apelit Administrativ në 2017-ën, kanë hyrë në rradhë për ekzekutim një dëmshpërblim total prej **14873 pagash**. Në dispozitivin e këtyre 1377 vendimeve të dhëna nga GJAA gjendet i përshkruar në mënyrë fikse totali i pagave që institucioni publik duhet t'i paguajë paditësit për pushim të padrejtë nga puna.
2. Në vitin 2017 janë dhënë edhe 137 vendime të cilat njohin të drejtën e paditësit për të marrë pagë deri sa ai/ajo të sistemohen në punë, pasi më parë është konstatuar largimi i tyre në kushte pa-ligjshmërie. Rezulton se deri në fund të vitit 2017, masa e këtij lloji dëmshpërblimi të pa-fiksuar në kohë apo në numër të caktuar pagash (psh 3 paga apo 12 paga mujore) kap një total prej **4130 pagash** (pagesa deri ne rikthime në pune për 137 çështje mund të ketë vijuar rritjen e vlerës së dëmshpërblimit gjatë vitit 2018)

Totali i pagave, të cilat do të duhet të paguhen nga fondet publike, konform urdhërimit të vendimeve të gjykatave administrative është i përlogaritur si shumë e dy kategorive bazë të mësipërme, ku (1) + (2) = 19003 paga gjithsej.

Ndërkohë janë 278 çështje gjyqësore me objekt marrdhëniet e punës për të cilat GJAA ka rrëzuar vendimin e shkallës së parë që i jepte të drejtë pretendimeve të paditësit ose kur vetë shkalla e parë i ka rrëzuar me vendim themeli pretendimet e paditësit; në këtë rast GJAA ka lënë në fuqi vendimin e saj. Kjo përfaqëson rreth 18% të çështjeve të vendimuara në vitin 2017, të cila ka analizuar ky studim (1514).



Sipas të dhënave zyrtare të INSTAT, paga mesatare në sektorin publik deri në fund të vitit 2017 ishte 61600 lekë ose rreth 493 Euro (kurs mesatar 125). Sipas kësaj konjunktore zyrtare, rezulton se pushimet nga puna në administratën publike, fatura e përgjithshme e cila do të duhet të ekzekutohet nga Shteti për çështjet gjyqësore të humbura prej tij në Apelin Administrativ në 2017-ën është rreth 1.17 miliard lekë të reja ose rreth 9.3 milion Euro.

Nga analizimi i të dhënave gjyqësore rezultojnë 5 çështje të vendimuara po në vitin 2017, për të cilat është urdhëruar nga gjykata detyrimi i palës "Shtet" për t'ju paguar paditësve vlerën monetare prej 38.139.120 leke ose rreth 305 mijë Euro në total. Në këto vendime të analizuara, masa e dëmshpërblimit nuk përlogaritet në numer pagash, por direkt si vlerë e përgjithshme financiare e padiferencuar në njësi kohore (psh. në muaj).

Në total, masa e dëmshpërblimeve që institucionet publike iu detyrohen të pushuarave nga puna, të cilët kanë fituar proceset gjyqësore në shkallë të dytë (GJAA) gjatë vitit 2017 përlllogaritet përafërsisht në 9.4 milion Euro.


Rezulton se në vitin 2017, GJAA ka vendimuar çështje me objekt “marrdhëniet e punës” të regjistruara në vitit 2014, 2015 dhe 2016 dhe vetëm pak prej tyre i takojnë vitit ankimimeve të regjistruara në vitin 2013.

Paga më lartë, e cila i është dëmshpërblyer me vendim përfundimtar gjykate, një funksionari publik është ajo e ish-Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, të cilit shteti shqiptar duhet t’i paguajë një total prej 35 448 650 lekë. Nga vlerësimi i ndërmarrë nga INFOCIP, rezulton se Gjykata e Lartë gjithashtu ka lënë në fuqi këtë vendim¹.

Tabela më poshtë ofron një paraqitje të mënyrës se si janë shpërndarë në fasha të ndryshme masa e dëmshpërblimit për paditësit që kanë fituar çështjet e tyre në GJAA. Rezulton se masa e dëmshpërblimit që haset më shpesh në vendimet gjyqësore që lihen në fuqi në shkallë të dytë është ajo nga 11 deri në 20 paga.

Fasha	Numri i çështjeve	Paga të dhëna
1-10 paga	376	2460 paga
11-20 paga	591	8628 paga
21-30 paga	175	4340 paga
Mbi 31 paga	90	3576 paga

SHPËRNDARJA NË FASHA E MASËS SË DËMSHPËRBLIMIT



¹ Link vendimi i GJL, A. Fullani: <https://www.gjykataehapur.al/wp-content/uploads/2018/11/1866.pdf>



PERFUNDIME DHE REKOMANDIME

MARDHENIET E PUNES NE GJYKATE

Për të dyja vitet e marra së bashku, pra 2017 dhe 2018, në total përlllogaritet një total prej 30 mijë pagash të cilat duhen paguar në formë dëmshpërblimi ndaj paditsve të cilat kanë mundur të fitojnë gjyqet me institucionet publike. Për kohën që monitoron ky studim, numri i saktë i pagave të cilat me vendim gjykate duhet t'i dëmshpërblehen të pushuarve nga puna që kanë fituar të drejtën në gjykatën administrative në të dyja shkallët është 29628 paga. Kjo shifër është rrumbullakosur në “30 mijë” për efekt të një kategorie vendimesh gjyqësore të cilat përcaktojnë detyrimin për dëmshpërblim me pagë deri në momentin e rregullimit në punë.

Vlera e përafërt e faturës financiare për buxhetin e shtetit nga paditësit që fituan çështjen e tyre në të dyja shkallët e gjykimit administrativ është përlllogaritur në rreth 14.7 milion euro. Nëse përlllogaritet mos-ekzekutimi në kohë për ato vendime gjyqësore të cilat kanë përcaktuar dëmshpërblim deri në kthimin në punë të palës paditëse, kjo faturë mund të përgjithësohet në rreth 15 milion Euro për dëmshpërblim page (vendime apeli administrativ 2017 dhe 2018).

Ky vlerësim Special Tematik konstaton gjithashtu se ka thujse një përgjysmim të masës së dëmshpërbimit në vitin 2018 krahasimisht me vitin 2017 në shkallën e dytë të gjykimit administrativ. Nga shqyrtimi i të dhënave vihet re një ulje e lehtë e fluksit të ankesave gjyqësore të vendimuara në 2018-ën krahasimisht me një vit më parë (rreth 200 më pak krahasuar me 2017-ën).


Në total për vitin 2018, GjAA dha gjithsej 4743 vendime për çështje administrative themeli. Prej këtij totali, **1400 vendime** rezultojnë për çështje gjyqësore me objekt marrdhëniet e punës. Këto përfaqësojnë 29.5% të totalit të ngarkesës gjyqësore për vitin 2018 në GjAA.

Në total për vitin 2017, GjAA dha gjithsej 5521 vendime përfundimtare për çështje administrative themeli. Prej këtij totali, **1601 vendime** janë dhënë për çështje gjyqësore me objekt marrdhëniet e punës. Këto përfaqësojnë afërsisht 30% të totalit të ngarkesës gjyqësore për vitin 2017 në GjAA.

Në tërësi, kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit gjyqësor administrativ në shkallë të dytë për vitin 2018 rezultoi 745 ditë. Kjo shifër përfaqëson të dhënat e gjashtëmujorit të parë dhe përshkruan kohën nga regjistrimi i ankimit në gjykatë dhe deri në vendimin e tij. Të dhënat e çështjeve me objekt “marrdhëniet e punës” janë evidentuar ndërkohë plotësisht dhe janë të shfletueshme në Platformën www.gjykataehapur.al në linkun: <https://www.gjykataehapur.al/demshperblimi-per-pushim-te-padrejte-nga-puna-rekurset-ne-gjykatën-administrative-te-apelit-viti-2018-2/>

Ndërkohë, kohëzgjatja mesatare e shqyrtimit gjyqësor administrativ në shkallë të dytë për vitin 2017 rezultoi 677.7 ditë ose rreth 1.85 vjet.

Grafiku më poshtë vizualizon kohëzgjatjen e shqyrtimit gjyqësor për çështjet me objekt marrdhëniet e punës krahasuar me pjesën tjetër të padive. Vihet re se ka një prirje pozitive nga ana e GjAA për të gjykuar më shpejt konfliktin e puëns që mbërrin në gjykatë.



Nga një vlerësim sistematik i kohëzgjatjes së shqyrtimit gjyqësor rezulton se, për të përmbyllur gjykimin e një çështje me objekt marrdhëniet e punës nga momenti i depozitimit të padisë në shkallë të parë dhe deri në dhënien e një vendimi në shkallë të dytë nevojiten mesatarisht 830 dite ditë ose rreth 2.3 vjet.

Në këtë rezultat nuk janë përfshirë edhe vonesat eventuale që mund të verifikohen sa i takon arsyetimit dhe dorëzimit të vendimeve në të dyja shkallët e gjyimit (7 ditë në shkallë të parë dhe 7 ditë në shkallë të dytë). Në vlerësimet e INFOCIP, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi sa i takon shqyrtimit administrative, kohabrenda të cilës duhet të zgjidhet një mosmarrveshje e tillë administrative duhet të mos i kalojë 90 ditë, për të mos shkaktuar pasoja me dëm ekonomik mbi buxhetin e shtetit.

Një kohë e tillë do ta bënte të mundur kapjen e afateve që përshkruan Kodi i Procedurave Administrative për rikthimin në punë të paditësve përmes ekzekutimit të një vendimi gjyqësor të formës së prerë para se të lidhet një kontratë e re definitive pune me zëvendësuesin, në të njëjtin pozicion pune.

Ky konflikt afatesh, si dhe pamundësi objektive e Gjykatave Administrative për të gjykuar shpejt mendohet se ka sjellë në situatën kur për të njëjtin pozicion pune në administratë nga buxheti i shtetit paguhen dy paga, dhe në disa raste më të rralla edhe tre paga.

INFOCIP konstaton gjithashtu se, për shkak të praktikës të vlerësimit të dëmit ekonomik, pala e paditur për pushim të padrejtë nga puna në gjykatë administrative (institucioni publik) ankimon në Apel a-priori çështjet gjyqësore të humbura në shkallë të parë. Kjo shton artificialisht fluksin e ngarkesës gjyqësore për këtë gjykatë, e cila përballon e vetme gjithë barrën e ankimeve administrative në RSH.

INFOCIP konsideron se numri aktual i gjyqtarëve të GJAA është i pamjaftueshëm për të përballur ngarkesën e lartë që prodhohen si rezultat i ankimeve me detyrim-përcaktim në Apel nga pala e paditur (institucionet shtetërore).

INFOCIP konsideron gjithashtu se sistemi i gjykatave administrative përfaqëson të vetmen vijë mbrojtëse për të drejtat ligjore të punonjësve në Republikën e Shqipërisë. Ky është një mision fisnik, për të cilin Gjykata Administrative duhet mbështetur me trupën e nevojshme të gjyqtarëve, për të shqyrtuar në afat sa më të shpejtë ankimet për shkelje të këtyre të drejtave.



Për fat të keq, ndryshimet ligjore që pësoi ligji 49/2012 në vitin 2016, kanalizojnë një pjesë të madhe të konfliktit gjyqësor me objekt marrdhëniet e punës në sistemin e gjykatave të zakonshme. Të gjithë ata punonjës të cilët nuk kanë ende statusin e nëpunësit civil, por që mund të pushohen nga puna për arsye që ata i konsiderojnë jo-ligjore, do të duhet këtej e tutje ta kërkojnë të drejtën e tyre në gjykatat civile të rretheve. Në cilësinë e paditësit, ata do të duhet të mbajnë edhe barrën e provës, përveç barrës së vështirësisë ekonomike që mund t'ju ketë shkaktuar pushimi nga puna. Në vlerësimet e INFOÇIP, çështja e shqyrtimit të marrdhënieve të punës në gjykatë duhet ri-hapur dhe duhet analizuar me shumë kujdes. Pjesë e këtij diskutimi duhet të jenë më së pari aktorët vendimarrës dhe ligjzbatues institucionalë.

INFOCIP konsideron se sindikatat kanë shumë për të ofruar në këtë diskutim publik dhe ligjor, në dobi të interesave legjitime që ato kanë përsipër të përfaqësojnë. INFOCIP nuk është ndalur për në këtë studim për të vlerësuar më imtësisht se sa përqind e çështjeve gjyqësore me objekt marrdhëniet e punës janë iniciuar nga përfaqësuesit juridikë të sindikatave dhe sa të tjera janë hapur individualisht nga individët që kanë humbur vendin e punës. Ky vlerësim duhet ndërmarrë sa më parë, për të parë më në thellësi rolin që vetë sindikatat luajnë apo mund të luajnë në këtë drejtim.

INFOCIP konsideron se sistemi i Gjykatave Administrative, për nga vetë natyra e tij, ofron garanci të shtuara për marrdhëniet e punës dhe respektimin e kontratave vetëm për sektorin publik. Nuk ka ende një studim të posaçëm se në cilën masë këto të drejta ankimohen në gjykatën civile për punonjësit e sektorit privat. Këto të dhëna kanë filluar gjithsesi të mblidhen nga INFOCIP, por analizimi i tyre do të kërkojë kohë, për shkak të numrit shumë të madh të vendimeve gjyqësore që duhen analizuar për këtë qëllim. Vetën në vitin 2017, në Gjykatën e Faktit Tiranë, dhoma civile dha 11 110 vendime gjyqësore themeli.

INFOCIP e konsideron të domosdoshme në këtë drejtim vlerësimin e raportit të çështjeve të hapura në gjykatën civile dhe në atë administrative me objekt marrdhëniet e punës. Bazuar në disa vlerësime paraprake, aksesin në drejtësi për punonjësit e sektorit privat dhe garancitë ligjore për të garantimin e barazisë së palëve janë deficitare për sektorin privat krahasuar me punonjësit në sektorin publik. Megjithatë, një studim i plotë nevojitet të ndërmerret në këtë drejtim, edhe për të parë efektin që ka në fitimin (ose jo) të çështjes barra e provës në gjykatë.

Nuk ka të dhënë publike për momentin se cila është sasia/masa e dëmshpërblimit që paguhet në rast të fitimit të padisë në gjykatën civile nga punonjësit e sektorit privat. Këto të dhëna duhet të fillojnë të gjenerohen dhe për këtë nevojitet së pari vizion nga institucionet donator për të aktivizuar një proces të posaçëm vlerësimi, i cili lejon më pas vendimarrësit politikë të njohin situatën reale dhe të orientojmë më mirë politikën ligjore në këtë drejtim.

Rruga "Todi Shkurti" 21/34 Tirane, Albania | E Hene - E Premte 09:00am - 05:00pm | info@gjykataehapur.al

GYKATA E HAPUR
OPEN COURT

Home | Rreth nesh | Raporte | Konferenca | Sherbime | Donatore

DEMSPERBLIMI PER PUSHIM TE PADREJTE NGA PUNA. VENDIME PERFUNDIMTARE NE GJYKATEN ADMINISTRATIVE TE APELIT, VITI 2017 / DATAZA

Nr.Vendimi: _____ Nr. Regjistri: _____ Data e Vendimit: _____ Dëmshpërblimi financiar: _____
 Nr.Vendimi _____ Nr. Regjistri _____ From _____ Dëmshpërblimi financiar _____ CLEAR FILTERS
 To _____

Show 100 entries

Nr.Vendimi	Nr. Regjistri	Data e Vendimit	Dëmshpërblimi financiar	Skeda e Gjykimit
1.207	31003-01376-86-2015	23.03.2017	15 paga	SHKARKO
1.388	31003-02331-86-2015	05.04.2017	29,5 paga	SHKARKO
1.412	31003-03468-86-2015	05.04.2017	35,5 paga	SHKARKO
1.168		21.03.2017	33 paga	SHKARKO
102			46 paga	SHKARKO
1.153			22 paga	SHKARKO
29				SHKARKO
995				SHKARKO
740				SHKARKO

Detajet e çështjes

Nr. i çështjes:

31003-01376-86-2015

Data e regjistrimit: 16-03-2015

Palët

Paditës:

Xhelal Lita

I paditur:

Drejtoria e Sherbimit te Trupit Diplomatik

Kundershtimi I aktit administrativ urdherin nr 183 dt 28.4.2014 te pales se paditur per zgjidhjen e kontrates se punes dhe ndërprerjen e marrëdhënieve financiare te paditesit Xhelal Lita me detyre mekanik saldator ne DSHTD -Detyrimin e pales se paditur te demshperbleje paditesin me pajustificuar te kontrates se punes -Detyrimin e pales se paditur te demshperbleje paditesin me pagen e 3 muajve per afatin e njoftimit Detyrimin e pales se paditur te me demshperbleje paditesin me pagen e 2 muajve per mosrespektimin te procedures se pushimit n

Objekti:

Alkelina Gazidedja

Relatori: Alkelina Gazidedja
 Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, pasi ka marrë në shqyrtim çështjen me vendimin përfundimtar Nr. 6323, datë 06.11.2014, ka vendosur:
 Rezimin e kerkeseпадise te paditesit Xhelal Lita. Shpenzimet gjyqësore, duke përfshirë shpenzimet e procedures se ckkzekutimit dhe tarifa per venien ne ckkzekutim, i ngarkohen pales se paditur.

Gjykata Administrative e Apelit vendosi:
 Gjykata Administrative e Apelit vendosi:
 Gjykata Administrative e Apelit vendosi:
 Gjykata Administrative e Apelit vendosi:

